



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

SHPLLJE PËR POZICIONIN SPECIALIST

Në zbatim të Vendimin Nr. 132, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”, si dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr. 94, datë 12.06.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”.

Specialist, në Sektorin e Statistikës, Informacionit dhe Nxitjes së Performancës, në Drejtorinë e Monitorimit dhe Performancës

Afati për dorëzimin e dokumenteve 28/06/2024 pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Kontribuon në hartimin e metodologjise për matjen e indikatorëve me synim për të siguruar bazën për përpunimin e politikave për fushën e veprimit;
- Përgatit raporte të nivelit të zbatimit sipas indikatorëve të përcaktuar në dokumente;
- Mbledh dhe analizon të dhëna statistikore, si dhe administron e analizon studimet e kryera nga organizma të tjerë të njohura, në fushën e të dhënave statistikore me fokus menaxhimin e mbetjeve;
- Ndjek në mënyrë periodike sistemin e menxhimit të performancës bazuar në objektivat institucionale;
- Ndjek në mënyrë të vazhdueshme dhe përditëson ecurinë e zbatueshmërisë së detyrave/objektivave të vendosur në planet e punës;
- Përgatit dhe raporton evidencat statistikore pranë eprorit, në afatet kohore të përcaktuara;
- Bashkëpunon dhe koordinon proceset e punës në përmbushje të vizionit të politikave dhe objektivave strategjike në fushën e zhvillimit të mjedisit dhe strategjisë sektoriale të mbetjeve;
- Kontribuon lidhur me ngritjen dhe mbajtjen e sistemeve në funksion të digjitalizimit të punës dhe shërbimeve në fushën e mjedisit, si dhe harton pyetësorë, metodika dhe udhëzues të udhëhequr nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ;

KUSHTET PËR PRANIM DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për pranim si dhe kriteret e veçanta si vijon:

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojnë diplomë të ciklit të dytë të studimeve, të nivelit “Master Shkencor” / “Master Profesional”, në Shkenca Ekonomike;
- d. Të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- e. Të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës;
- f. Të ketë aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritete dhe respektuar afatet;
- g. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi;
- h. Të ketë aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe procedurave të reja
- i. Të kenë aftësi të mira të procedurave administrative;
- j. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës/diplomave dhe listes se notave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (në momentin e fillimit të marrëdhënieve të punës);
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g. Certifikata për trajnime në lidhje me pozicionin për të cilin konkurojnë;
- gj- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në MTM brenda datës 28/06/2024

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT TË DOKUMENTACIONIT

Komisioni Ad-Hoc do të shpallë në faqen zyrtare të MTM-së www.turizmi.gov.al, tek kategoria/menuja “Njoftimet”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për intervistën e strukturuar me gojë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të intervistohen për njohuritë mbi dokumentet e listuara më poshtë:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10431, datë 9.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, i ndryshuar;

- Njohuri mbi VKM-në nr. 418, datë 27.05.2020 “Për miratimin e dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Njohuri mbi Vendimin Nr. 132, datë 6.03.2024, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen edhe në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE KOMUNIKIMI

Kandidatët do të vlerësohen me pikë si më poshtë:

- a- Intervistën e strukturuar me gojë, deri në 60 pikë;
- b- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 40 pikë.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore në MTM do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) dhe do të shpallë fituesit në faqen zyrtare të ministrisë.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentacioneve të cituara më sipër, duhet të bëhet brenda datës 28.06.2024 në protokollin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;

Zhvillimi i intervistës do të zhvillohet në datën 8.07.2024, në ambientet e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;